



Shtesa dhe ndryshime në lidhje me procedurat, dokumentacionin dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe për të larguarit nga puna si pasojë e Covid-19

Në Fletoren Zyrtare nr. 97 është publikuar Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 423, datë 28.05.2020 i cili sjell disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 305, datë 16.04.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19". Ju lutem referojuni Njoftimit nr. 33 të publikuar më herët nga Deloitte Albania lidhur me VKM nr. 305, datë 16.04.2020.

VKM ndryshuese parashikon dhënien e ndihmës financiare në masën 40,000 lekë, ndër të tjera, edhe për ish të punësuarit në subjekte që janë lejuar të kryejnë aktivitetet ose janë mbyllur sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, **të cilët janë larguar nga puna nga data 01.03.2020 deri në 17.05.2020** (më parë, afati për të larguarit nga puna ishte deri në datën 10.04.2020).

Në rastet kur subjektet nuk aplikojnë për përfitimin e ndihmës financiare për të punësuarit apo të ish-punësuarit e tyre, ndihma financiare do të jepet pas miratimit nga administrata tatimore bazuar në të dhënat që zotëron ajo dhe në të dhënat që të punësuarit apo të ish-punësuarit do të dorëzojnë pranë saj. Të dhënat e mëposhtme:

- I. Të dhënat e subjektit tatimpagues;
- II. Të dhënat identifikuese të përfituesit;
- III. Banka dhe numri i llogarisë bankare të përfituesit,

duhet të dorëzohen deri më 05.06.2020.

Për të punësuarit apo të ish-punësuarit që përfitojnë ndihmën financiare në bazë të këtij vendimi, nuk lejohet përfitimi në të njëjtën kohë nga paketat e tjera të mbështetjes shtetërore të pagesës së ndihmës ekonomike apo të pagesës së të ardhurës nga papunësia.

Lista emërore e individëve përfitues të Paketës Financiare 2 dhe lista e NIPT-eve të subjekteve tatimpaguese përkatës janë publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Parashikimet e mësipërme ligjore hyjnë në fuqi në mënyrë të menjëhershme duke filluar nga data 29.05.2020.



Additions and amendments regarding the procedures, documentation and the amount of financial assistance for current employees and for dismissed employees due to Covid-19

The Decision of the Council of Ministers (DCM) no. 423, dated 28.05.2020, published in the Official Gazette no. 97, brings some additions and amendments to the DCM no. 305, dated 16.04.2020 "On determining the procedures, documentation and the amount of financial assistance for current employees and dismissed employees due to Covid-19". Please refer to Notification no. 33 published earlier by Deloitte Albania on the DCM no. 305, dated 16.04.2020.

The amending DCM foresees the provision of the financial assistance in the amount of 40,000 Lekë, among others, to former employees in entities that have been allowed to carry out activities or have been closed according to the orders of the Minister of Health and Social Protection, **who have been dismissed from 01.03.2020 to 17.05.2020** (*previously, the deadline for dismissed employees was until 10.04.2020*).

In cases where entities do not apply for financial assistance for their employees or former employees, the financial assistance will be provided upon approval by the tax administration based on the data held by the latter and on the data employees or former employees shall submit. The following data:

- I. Data of the entity (employer);
- II. Identifying data of the beneficiary (individual);
- III. Bank and bank account number of the beneficiary (individual),

must be submitted within 05.06.2020.

For the current or former employees that benefit the financial assistance based on this decision, the simultaneous benefit from other governmental packages such as the economic assistance or the unemployment income is not allowed.

The nominal list of beneficiary individuals for the Financial Package 2 and the list of NUIS of the respective entities (employers) have been published in the official website of the General Tax Directorate.

The above legal provisions are effective immediately starting on 29.05.2020.